

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
" VLADIMIR LLESHAJ " SH.P.K.**



Sot, më datë 09 Mars 2006 , une i nenshkruari:

- Z. . VLADIMIR LLESHAJ , i biri i Vlash , lindur me 08 Prill 1978 ne Mirdite , me banim ne Tirane me adrese Fusha e Aviacionit , mbajtes i pasaportes me nr. Z1720127 , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar,

në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 14.12.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar " VLADIMIR LLESHAJ " Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria"), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është " VLADIMIR LLESHAJ " SH.P.K.

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresen:Rruga "Dervish Hima ",perballe Ambasadës Amerikane Tirane. Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë vendin.

Neni 3

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë e pakufizuar , duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Rregjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë.

Shoqëria mund të përfundojë apo vihet në likuidim përpara këtij afati ose mund të zgjasë aktivitetin e saj me vendim të Asamblesë së Ortakut te Vetem.

Neni 4

Objekti i Shoqërisë është si vijon:

- Tregëtim me pakice i mallrave te ndryshem ushqimore e industriale si produktet blektorale , frutat ,perimet , mallrat ushqimore , industriale,detergjentet, artikuj kozmetik , parfumeri , pije alkolike , prodhime deti etj

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kapitali themeltar është i përbërë nga 100 (njëqind) pjesë kapitali, të gjitha të nënshkruara dhe të paguara, me vlerën prej 1,000 (njëmijë) lekë secila.

Neni 6

Derdhja e kapitalit themeltar është bërë në mënyrën e mëposhtme:

-Z.Vladimir Lleshaj , ka derdhur në para shumën prej 100.000 leke, me anë të depozitimit të saj ne llogari bankare.

Neni 7

Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurave të parashikuara ne Statutin e shoqerise.

Neni 8

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj nepermjet Vendimeve te Ortakut te Vetem te saj.

Shoqëria administrohet nga Administratori i vetem i shoqerise, Z. VLADIMIR LLESHAJ , i biri i Vlash , lindur me 08 Prill 1978 ne Mirdite ,me banim ne Tirane me adrese Fusha e Aviacionit , mbajtes i pasaportes me nr. Z1720127 , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Administratori ka liri te plote per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojne Asamblese se Ortakut te Vetem. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Adminstratori.

Neni 9

Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

Neni 10


Ortaku i Vetem i shoqerise mund te delegoje kompetencat e tij vetem per ato qe i perkasin funksioneve te tij si administrator.

Neni 11

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

Nënshkruar nga Ortaku i Vetem:

VLADIMIR LLESHAJ

Vladimir Lleshaj


Tiranë, më 09 Mars 2006

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË**

Nr. 1146 Rep.
Nr. 205 Kol.



VËRTETIM

Sot më datë 10 Mars 2006 , para meje ANILA GJERMENI ,Notere Publike prane Dhomes se Notereve Tirane u paraqit personalisht:

Z. VLADIMIR LLESHAJ , i biri i Vlash , lindur me 08 Prill 1978 ne Mirdite ,me banim ne Tirane me adrese Fusha e Aviacionit , mbajtes i pasaportes me nr. Z1720127 , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar,

i cili me deklaroi se dokumenti i bashkengjitur ketij Vertetimi eshte Akti i Themelimit te Shoqerise " Vladimir Lleshaj " SHPK, i hartuar me vullnetin e tij te lire dhe te plote, dhe une, noterja e vërtetoj nenshkrimin e tij rregullisht sipas ligjit.

**NOTERE
ANILA GJERMENI**



STATUTI I SHOQËRISË
" VLADIMIR LLESHAJ " SH.P.K.

Në bazë të ligjit 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", dhe ligjit nr. 7667, datë 28.1.1993 "Për Regjistrin Tregtar", une i nenshkruari shpall si më poshtë vijon:

FORMIMI I SHOQËRISË

Neni 1

Formohet shoqëria e quajtur " VLADIMIR LLESHAJ " SH.P.K.. me ortakë te vetem:

- Z.VLADIMIR LLESHAJ , i biri i Vlash , lindur me 08 Prill 1978 , ne Mirdite , mbajtes i pasaportes me nr. Z1720127, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

QENDRA E SHOQËRISË

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresen Rruga "Dervish Hima ", perballe Ambasadës Amerikane Tirane. Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë vendin.

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon që prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqsor , Tiranë.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

- Tregetim me pakice i mallrave te ndryshem ushqimore e industriale si produktet blektorale , frutat ,perimet , mallrat ushqimore , industriale, detergjente , artikuj kozmetik , parfumeri , pije alkolike , prodhime deti etj

Neni 5

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë kapitalin sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Leke, kapital ky i depozituar ne llogari bankare.

Kapitali zotërohet 100% nga ortakët i vetëm i shoqërisë Z. Vladimir Lleshaj

Ky kapital mund të shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit të të gjithë ortakëve.

Neni 7

Kapitali shoqëror është i ndarë në kuota të madhësive të ndryshme por asnjëherë më e vogël se 1.000 lekë. Cdo ortak ka të drejtën e votës. Kuotat që janë më të mëdha se 1.000 lekë i japin të drejtën e një vote për cdo 1.000 lekë.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut si dhe të legjislationit shqiptar në fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar në datën e regjistrimit në Regjistrin Tregtar në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe pasi të marrë licensën përkatëse nga organi përkatës tatimor.

Neni 9

Ortakët e shoqërisë me krijimin e kësaj shoqërie pjesën e kapitalit të derdhur prej tyre nuk mund ta tërheqin. Kjo mund të bëhet vetëm pasi të nxirret bilanci i shoqërisë për fitimin e realizuar.

Neni 10

Pjesët shoqërore të cdo anëtari përputhen me pjesën e tyre në kapitalin e shoqërisë. Cdo anëtar mund të ketë një pjesë shoqërore, nëqoftesë anëtari siguron pjesë të tjera shoqërore atëherë pjesa e tij rritet në përputhje me këtë. Pjesët e tij anëtari i shoqërisë mund t'ua ofrojë të tretëve. Anëtarët e shoqërisë kanë përparësi për blerjen e pjesës shoqërore përpara personave të tretë jashtë shoqërisë. Ortaku që dëshiron të transferojë ose të shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim Organit Administrativ duke saktësuar cmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i arsyeshëm dhe të jetë i njëjtë me atë që do t'i ofrohet dhe një personi të tretë jashtë shoqërisë si dhe të dhënat e blerësit. Organi administrativ jep përgjigje brenda 30 ditëve nga data e njoftimit dhe duhet t'ua transmetojë ortakëve të tjerë këtë kërkesë dhe ortakët e tjerë duhet të japin një përgjigje brenda 3 muajve. Edhe e drejta e përparësisë duhet të ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Organit Administrativ.

E drejta e përparësisë është në proporcion me kuotat e secilit prej ortakëve. Organi Administrativ pasi ka kaluar afati prej 3 muajsh, brenda 30 ditëve i komunikon ortakut që shet kuotat e tij vendimin e ortakëve të tjerë për të blerë të gjithë ose pjesërisht kuotat e tij. Në rast se kuotat nuk shiten brenda shoqërisë, atëherë këto kuota brenda 90 ditëve i ofrohen personave të tretë jashtë shoqërisë. Transferimi dhe shitja e kuotave duhet të bëhen me akte noteriale dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e Ortakëve.

Po kështu transferimi i kuotave në rrugë trashëgimie bëhet sipas neneve 46, 47, 49 të



ligjit 7638 dt 19.11.1992. Te gjitha transferimet kane efekt mbi shoqerine qe nga momenti i regjistrimit ne librin e Ortakeve. Kuotat prej 1.000 leke jane te pandashme. Ne rastet e bashkepronesise veprohet sipas ligjeve.

Neni 11

Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratoreve, si dhe emrat e Ortakeve duhet te jene te pmendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

Neni 12

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore. Ortaket e shoqerise drejtojne procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve pa asnje kufizim.

- 1- Vendimeve te Ortakut te Vetem te Shoqerise
- 2- Adminstratori

KOMPETENCAT E ORTAKUT TE VETEM

Neni 13

Per menyren e drejtimit dhe ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, Ortaku i Vetem shprehet me vendime personale per gjithshka qe eshte ne kompetencat e tij te pershkruara si me poshte:

- Ka te drejte te beje ndryshime ne statut.
- Ka te drejte te miratoje bilancin e shoqerise dhe te beje ndarjen e fitimit.
- Ai emeron administratorët, zevendesin, ekspertet dhe revizoret kontabel.
- Ai aprovon cdo lloj veprimi financiar qe me ligj dhe me marrëveshje lihet ne kompetencat e tij.
- Miraton zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit.
- Percakton shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.
- Bën transferimin e kuotave te te tretet.
- Bën lidhjen e kontratave per dhenie dhe marrje te drejtash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqerise si dhe kontrata ne lidhje me organet shteterore per pjesmarren ne tender, ankande ose aktivite te tjera te rendesishme.
- Realizon blerje, shitje si dhe tjetersim te pasurive te palujtshme te shoqerise etj.
- Ka te drejte te bëjë modifikimin e kontrates se shoqerise.
- Etj.

Neni 14

Kompetencat e Ortakut te Vetem per vendimet e pershkruara me lart nuk mund t'i delegohen askujt.



Neni 15

Marrja e vendimeve te Ortakut te Vetem, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

ADMINISTRIMI **Neni 16**

Administratori i shoqerise eshte Z. VLADIMIR LLESHAJ , i biri i Vlash , lindur me 08 Prill 1978, ne Mirdite ,me banim ne Fusha e Aviacionit Tirane , mbajtes i pasaportes me nr. Z1720127 ,madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar. Ortaku mund te vendose lejimin e nje shperblimi ne favor te Administratorit per kryerjen e detyres pervec pagimit te shpenzimeve.

Neni 17

Administratori mund te emeroje nje ose me shume administratore te deleguar ose perfaqesues te thjeshte per te kryer veprime te vecanta duke percaktuar fuqine e tyre brenda kufijve e duke e respektuar statutin dhe ligjet ne fuqi dhe vendos dhenien e nje shperblimi ne favor. Detyrat e tyre do te percaktohen ne nje rregullore te brendshme te shoqerise.

Neni 18

Administratori ka liri te plote per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojne Ortakut te Vetem. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Administratori.

DELEGIMI I KOMPETENCAVE **Neni 19**

Ortaku i Vetem i shoqerise mund te delegoje kompetencat e tij vetem per ato qe i perkasin funksioneve te tij si administrator.

MARREDHENIET E PUNES **Neni 20**

Mardheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektojte rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETTIT **Neni 21**



Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i shoqerise.

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL

Neni 22

Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithë aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Ortaku cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 23

Viti financiar dhe bilanci vjetor

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit. Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

BILANCI DHE FITIMET

Neni 24

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet ne dt. 31 Dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi vecohen fondet si me siper dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten i kalojne Ortakut te Vetem te shoqerise.

Neni 25

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, Ortaku i Vetem vendos brenda 4 muajve mundesine e prishjes se jashtezakonshme te shoqerise.

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 26


Ne rast se shoqeria shperndahet per cdo lloj arsye Asambleja e Ortakut te vetem percakton menyren e likuidimit, emeron nje ose me teper likuidator dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c'regjistrimin e saj nga Regjistri Tregtar.

LIBRAT E SHOQERISE

Neni 27

Po keshtu shoqeria ne baze te ligjit mban librat e meposhtem:



- 
- 1) Libri i Ortakut te Vetem
 - 2) Libri i Mbledhjeve
 - 3) Libri i vendimeve te administratorit
 - 4) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel.

Librat e mesiperm duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e mbyllur.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME
Neni 28

Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 7638 dt 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", Statutit dhe rregullores se brendshme te shoqerise. Cdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerise.

Ky statut firmoset rregullisht nga ortaku i vetem i shoqerise.

ORTAKU I VETEM

VLADIMIR LLESHAJ

Vladimir Lleshaj
